



PROJEKTI I MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

POSTA SHQIPTARE SH.A
Si Shoqëri Përthithëse

Dhe

INTERPOST SH.P.K
Si Shoqëri e Përthithur



POSTA SHQIPTARE SH.A

INTERPOST SH.P.K

Nr. 610/1 Prot. Tiranë, më 18/02/2016

Nr. 17 Prot. Tiranë, më 18/02/2016

**PROJEKT MARREVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE I SHOQERISE "INTERPOST" SHPK
NGA SHOQERIA "POSTA SHQIPTARE" SHA**

Ky projekt bashkimi me përthithje është hartuar nga:

- **Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a, z. Majlind Lazimi**

Dhe

- **Administratori i shoqërisë "Interpost" sh.p.k, z. Kujtim Sejati**

Ky projekt është iniciuar nga aksioneri i vetëm i shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a për realizimin e procesit të bashkimit me përthithje të INTERPOST sh.p.k nga POSTA SHQIPTARE sh.a.

1. POSTA SHQIPTARE sh.a, shoqëri anonime me kapital të rregjistruar prej 1,642,447,000 lekë, i ndarë në 1.642.447 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Rrugën Rreshit Çollaku, nr 4, Tiranë dhe krijuar me vendimin e gjykatës Tiranë nr. 20718 datë 03.02.1992, e përfaqësuar nga administratori ligjor i shoqërisë z.Majlind Lazimi, që për qëllim të kësaj marrëveshje POSTA SHQIPTARE sh.a do të quhet "Shoqëria Përthithëse",

dhe

2. INTERPOST shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital themltar të regjistruar prej 1,000,000 lekë, i ndarë në 1,000 kuota me vlerë 1,000 lekë/kuotë, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Rrugën Rreshit Çollaku, nr 4, Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë në 06.02.2012, e përfaqësuar nga administratori ligjor i shoqërisë z. Kujtim Sejati që për qëllim të kësaj marrëveshje INTERPOST sh.p.k do të quhet "Shoqëria e Përthithur".

DEKLARATA PARAPRAKE

- A. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Pjesa IX, Neni 215 deri tek Neni 225, me propozim të aksionerit të vetëm të shoqërisë hartohet kjo Projekt Marrëveshje për Bashkimin me përthithje të Interpost sh.p.k nga Posta Shqiptare sh.a.
- B. Duke qënë se POSTA SHQIPTARE sh.a është zotëruese në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë "INTERPOST" sh.p.k, një shoqëri e themeluar më 06/02/2012.



- C. Me qëllim përmirësimit e performancës ekonomike të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a në përputhje me objektivat e Shoqërisë, për të siguruar ofrimin e një impakti pozitiv në komunitet, me qëllim furnizimin me shërbime sa më të mira të të gjithë klientëve si dhe rritje të marzheve të fitimit, të cilat do të përmirësojnë flukset e parasë dhe rritjen e investimeve në teknologji.
- D. POSTA SHQIPTARE sh.a dhe INTERPOST sh.p.k dëshirojnë të kryejnë një Bashkim nëpërmjet të cilit POSTA SHQIPTARE sh.a do të përthithë shoqërinë Interpost sh.p.k dhe shoqëria POSTA SHQIPTARE sh.a do të vazhdojë aktivitetin kurse Interpost sh.p.k do të çrregjistrohet pa kaluar në likuidim.
- E. Më datë 25.09.2015 sipas Urdherit nr. 6016/1 si dhe më datë 10.12.2015, sipas urdherit numër 6016/3, të Ministrit për Zhvillimin Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a është kërkuar: Fillimi i procedurave për bashkimin nëpërmjet përthithjes të shoqërisë Interpost sh.p.k nga shoqëria POSTA SHQIPTARE sh.a, dhe u ngarkua Eksperti Kontabel i Regjistruar Znj. Diana Golemi (Ylli) që të hartojë Raportin e Bashkimit me përthithje të Interpost sh.p.k me Posta Shqiptare sha.
- F. Me Vendimin nr.5 date 26.12.2015 të Asamblese se Pergjithshme të shoqërisë “Interpost” sh.p.k është miratuar: Fillimi i procedurave për bashkimin nëpërmjet përthithjes të shoqërisë Interpost sh.p.k me shoqërine POSTA SHQIPTARE sh.a dhe është ngarkuar administratori i shoqërisë për përgatitjen e dokumentave të Bashkimit me Përthithje.
- G. Dy shoqëritë kanë rënë dakord për të hartuar këtë projekt-marrëveshje në mënyrë që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e Bashkimit.

Të dyja shoqëritë kanë rënë dakord si mëposhtë vijon:

Neni 1

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë Projekt-Marrëveshje, përveçse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalet e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Projekt-Marrëveshje” nënkupton këtë Projekt-Marrëveshje

“Shoqëri Përthithese” në këtë Projekt-Marrëveshje do të thotë shoqëria “POSTA SHQIPTARE” sh.a

“Shoqëri e Përthithur” në këtë Marrëveshje do të thotë shoqëria “INTERPOST” sh.p.k

“Data e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit ” (Data Efektive e Bashkimit) ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.1 që do të thotë data e miratimit të Projekt-Marrëveshjes nga Aksioneri i Vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare dhe Ortaku i Vetëm i shoqërisë Interpost sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit .



“Data e Bashkimit” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.4 që do të thotë data 31/12/2015.

“Informacion konfidencial” nënkupton çdo informacion, me shkrim ose me gojë në lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete të tjera të shoqërive POSTA SHQIPTARE sh.a dhe INTERPOST sh.p.k.

“Qënda Kombëtare e Regjistrimit” nënkupton njësinë e themeluar në bazë të ligjit nr.9723, datë 03/04/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

“Data e nënshkrimit” nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Projekt-Marrëveshje nga të dyja palet, ashtu sic tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj Projekt-Marrëveshje.

Neni 2

BASHKIMI, KËMBIMI I AKSIONEVE

- 2.1 Në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshje POSTA SHQIPTARE sh.a do të përthithë shoqërinë Interpost sh.p.k në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit (Data Efektive e Bashkimit) që është data e miratimit të Projekt-Marrëveshjes nga Aksioneri i Vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare dhe Ortaku i Vetëm i shoqërisë Interpost sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 2.2 Interpost sh.p.k do t'i transferojë shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a tërësinë e elementeve të aktivitetit të pasivitetit duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Bashkimit.
- 2.3 Si rezultat i operacionit të Bashkimit, Kapitali aksioner i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në Datën Efektive të Bashkimit mbetet i njëjtë me kapitalin para bashkimit, me përjashtim nëse Raporti i Ekspertit nuk përcakton ndryshe. Kapitali themeltar i shoqërisë Interpost sh.p.k netohet në bilancin e konsoliduar të të dy shoqërive me vlerën e pjesëmarrjes.
- 2.4 Data e Bashkimit është data 31.12.2015 që do të thotë që, të gjitha dhe çdo operacion i kryer nga Interpost sh.p.k që nga data 01 Janar 2016 deri në Datën e regjistrimit përfundimtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) do të konsiderohen si të kryera nga POSTA SHQIPTARE sh.a.
- 2.5 Statuti i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a, mbas ndryshimeve që mund t'i bëhen në Objektivin e veprimtarisë do të vazhdojë të jetë edhe Statuti i Shoqërisë Përthithëse.
- 2.6 Anëtarët e Organeve drejtuese të Shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve të Shoqërisë Përthithëse.
- 2.7 Administrator i shoqërisë Përthithëse do të jetë z.Majlind Lazimi i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.



Neni 3

EKSPERTËT

Me qëllim vlerësimin e kushteve të kësaj projekt Projekt-Marrëveshje të bashkimit, për të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedure bashkimi me përthithje, emërohet znj. Diana Golemi (Ylli), e bija e Bajramit, e dtl. 19 Tetor 1963, banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, Eksperte Kontabël e Regjistruar, anëtare e IEKA, mbajtëse e licencës me nr.9, dt. 10/02/2000.

Eksperti ngarkohet sipas ligjit të hartojë një raport me shkrim, nëpërmjet te cilit do të deklarojë dhe vlerësojë kapitalin e shoqërive.

Kapitali i shoqërisë përthithëse, (shoqërisë përfituese të kontributeve), pas realizimit të procesit të bashkimit me përthithje me shoqërinë “Interpost” shpk (shoqëria kontribuese), do të përbëhet nga kapitalet e seciles prej shoqërive në momentin e realizimit të këtij procesi, vlerë e cila do të përcaktohet me paraqitjen nga Eksperti Kontabel i Regjistruar të raportit për modalitetet e bashkimit dhe vlerësimin e kapitaleve të dy shoqërive “ Interpost” shpk dhe “ Posta Shqiptare” sha.

Shoqëritë pjesëmarrëse në këtë proces bashkimi me përthithje, garantojnë sipas ligjit se ekspertit do ti vihet në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentat përkatëse, me qëllim kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme.

Neni 4

AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PËR TU TRANSFERUAR

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikohet që Interpost sh.p.k t'i transferojë shoqërisë Posta Shqiptare sh.a tërësinë e elementeve të aktivitetit të pasivitetit gjendje më datë 31.12. 2015.

Grupet kryesore të këtyre aktiveve dhe pasiveve më datë 31 Dhjetor 2014 dhe 1 Janar 2015 që janë marrë si bazë për hartimin e projekt Projekt-Marrëveshjes së bashkimit paraqiten si vijon:

INTERPOST SH.P.K

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Lekë

AKTIVET	01 Janar 2015	31 Dhjetor 2014
Aktivet afatshkurtra		
Mjete monetare	1,109,317	1,109,317
Llogari të arkëtueshme tregtare	4,442,179	4,442,179
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	43,737,726	43,737,726
Inventari	368,203	368,203
TOTALI i Aktiveve afatshkurtra	45,657,425	45,657,425



Aktivet afatgjata		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	111,570,378	111,570,378
Aktivet afatgjata jomateriale	75,722,711	75,722,711
TOTALI i Aktiveve afatgjata	187,293,089	187,293,089
TOTALI I AKTIVEVE	236,950,514	236,950,514
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshme ndaj furnitoreve	11,820,621	11,820,621
Të pagueshme ndaj punonjësve		
Detyrime tatimore	545,730	545,730
Llogari të pagueshme të tjera	615,316,964	615,316,964
Totali i detyrimeve afatshkurtra	627,683,315	627,683,315
Detyrimet afatgjata		
Totali i detyrimeve afatgjata	-	-
Totali i detyrimeve	627,683,315	627,683,315
Kapitali		
Kapitali themeltar	1,000,000	1,000,000
Fitim humbje te mbartura	(195,605,350)	(195,605,350)
Fitim humbje te vitit ushtrimor	(196,127,451)	(196,127,451)
Total Kapitali	(390,732,801)	(390,732,801)
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	236,950,514	236,950,514

Ndërkohë të dhënat e bilancit të Posta Shqiptare Sha më datë 1 Janar 2015 dhe 31 Dhjetor 2014 që janë marrë si bazë për hartimin e projekt Projekt-Marrëveshjes së bashkimit janë si më poshtë:

POSTA SHQIPTARE SH.A

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Lekë	
	01 Janar 2015	31 Dhjetor 2014
AKTIVET		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	2,416,716,864	2,416,716,864
Aktivet afatgjata jomateriale	40,730,628	40,730,628
Llogari të tjera të arkëtueshme	450,000,000	450,000,000
Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	1,000,000	1,000,000
Total Aktiveve Afatgjata	2,908,447,492	2,908,447,492
Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	206,498,951	206,498,951
Llogari të arkëtueshme tregtare	567,812,015	567,812,015



Llogari të arkëtueshme të tjera	1,200,466,124	1,200,466,124
Mjetet monetare në arkë e në bankë	2,364,237,428	2,364,237,428
Total aktive afatshkurtra	4,339,014,518	4,339,014,518
Total aktive	7,247,462,010	7,247,462,010
Kapitali aksionar		
Kapitali aksionar	1,642,447,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivlerësimi	1,380,951,364	1,380,951,364
Rezerva ligjore	103,250,221	103,250,221
Rezerva të tjera	1,044,369,902	1,044,369,902
Fitime të mbartura	12,068,326	12,068,326
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	229,699,353	229,699,353
Total kapitali aksionar	4,412,786,166	4,412,786,166
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Hua afatgjata		
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	194,319,765	194,319,765
Detyrime të tjera afatgjata	450,000,000	450,000,000
Total Detyrime afatgjata	644,319,765	644,319,765
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	265,386,386	265,386,386
Detyrimet tatimore	36,823,680	36,823,680
Detyrime ndaj punonjësve	5,935,044	5,935,044
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera	10,894,081	10,894,081
Llogari të pagueshme të tjera	1,871,316,888	1,871,316,888
Total Detyrime afatshkurtra	2,190,356,079	2,190,356,079
Totali i detyrimeve	2,834,675,844	2,834,675,844
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	7,247,462,010	7,247,462,010

Mbas realizimit të operacionit të bashkimit të dhënave e bilancit të Posta Shqiptare Sha më datë 01.01.2015 mbas bashkimit me përthithje paraqiten si më poshtë:

POSTA SHQIPTARE SH.A

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Lekë

	<u>01 Janar 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
AKTIVET		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	2,528,287,241	2,528,287,241
Aktivet afatgjata jomateriale	116,453,339	116,453,339
Llogari të tjera të arketueshme	450,000,000	450,000,000
Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	-	-
Total Aktiveve Afatgjata	3,094,740,581	3,094,740,581



Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	206,867,154	206,867,154
Llogari të arkëtueshme tregtare	572,254,194	572,254,194
Llogari të arkëtueshme të tjera	628,886,886	628,886,886
Mjetet monetare në arkë e në bankë	2,365,346,745	2,365,346,745
Total aktive afatshkurtra	3,773,354,979	3,773,354,979
Total aktive	6,868,095,560	6,868,095,560
Kapitali aksionar		
Kapitali aksionar	1,642,447,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivlerësimi	1,380,951,364	1,380,951,364
Rezerva të tjera	103,250,221	103,250,221
Rezerva ligjore	1,044,369,902	1,044,369,902
Fitime të mbartura	(183,537,024)	(183,537,024)
Fitimi i ushtrimit	33,571,902	33,571,902
Total kapitali aksionar	4,021,053,365	4,021,053,365
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Hua afatgjata		
Tatimi i shtyre mbi fitimin	194,319,765	194,319,765
Detyrime të tjera afatgjata	450,000,000	450,000,000
Total Detyrime afatgjata	644,319,765	644,319,765
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	277,207,007	277,207,007
Detyrimet tatimore	37,369,410	37,369,410
Detyrime ndaj punonjesve	5,935,044	5,935,044
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera	10,894,081	10,894,081
Llogari të pagueshme të tjera	1,871,316,888	1,871,316,888
Total Detyrime afatshkurtra	2,202,722,430	2,202,722,430
Totali i detyrimeve	2,847,042,195	2,847,042,195
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	6,868,095,560	6,868,095,560

Neni 5

MODALITETET

Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Interpost sh.p.k në datën e bashkimit.

Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a në datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga Interpost sh.p.k në këtë datë.



Punonjësit e shoqërisë Interpost sh.p.k do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punonjës te Posta Shqiptare sha.

Neni 6

GARANCITË PËR KREDITORËT DHE MBROJTJA E TYRE

Themelore në këtë procedurë bashkimi me përthithje e shoqërive të mësipërme, është garantimi i kreditorëve të shoqërive të përfshira në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur (nëse ka, pasi kjo do të pasqyrohet pas raportit të ekspertit kontabël të Regjistruar), për faktin se megjithëse debitori fillestar humbet (pra shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen shoqërisë përthithese “Posta Shqiptare” sh.a.

Shoqëria përthithese merr përsipër sipas ligjit të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretet, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur ti drejtojnë pretendimet e tyre ndaj shoqërisë përthithese

Neni 7

DATA KONTABËL

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisë Interpost sh.p.k nga data 1 Janar 2016 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKR-së, datë në të cilin do të ndodhi cregistrimi pa likujdim i shoqërisë Interpost shpk, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithese “Posta Shqiptare” sh.a. dhe rregjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilën do të bëhet bashkimi është data 31 Dhjetor 2015, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dyja shoqërive i datës 31.12.2015.

Neni 8

DATA E PËRGATITJES (HARTIMIT) TË LLOGARIVE

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar kushtet financiare të bashkimit për këtë projekt bashkimi me përthithje, janë hartuar duke j'u referuar datës 01.01.2015, si për shoqërinë përthithese ashtu edhe për shoqërinë e përthithur. Ndërkohë që për hartimin e Projekt-Marrëveshjes Përfundimtare të Bashkimit me Përthithje llogaritë dhe kushtet financiare të bashkimit do të përcaktohen nga bilanci kontabël i datës 31.12.2015.

Neni 9



RAPORTET E KËMBIMIT

Duke konsideruar që Interpost shpk zotërohet 100% nga Posta Shqiptare sh.a, nuk ka raporte të këmbimit të kapitalit.

Neni 10

SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TË BASHKIMIT

Nga operacioni i mësipërm nuk do të rezultojë prim nga bashkimi.

Neni 11

TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Neni 12

PREMTIME DERI NË MBYLLJE

Deri në datën e mbylljes, Palët duhet që:

- a) Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Projekt-Marrëveshje si dhe dokumentat e tjera në lidhje me to.
- b) Të njoftojnë Bankën e Shqipërisë në lidhje me operacionin e bashkimit që po kryejnë.
- c) Të ndërmarrin çdo veprim për depozitim e të gjitha dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit para datës 20.02.2016 për ti dhënë efekt Bashkimit në Datën Efektive.

Neni 13

MBYLLJA E OPERACIONIT

Mbyllja e procesit të Bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në adresën: Rruga: Rreshit Çollaku, nr 4, (me adrese sekondare te ushtrimit te aktivitetit ne Terminal Center, Prane Spitalit Hygeia, Kthesa e Kamzes) Tiranë, sa më shpejt të jetë e mundur.

Në mbyllje ose para saj palët duhet të kenë bërë të mundur realizimin dhe dorezimin e dokumentave të mëposhtme:

- a) Të gjithë vendimeve të Asambleve dhe Keshillit Mbikqyres në lidhje me këtë operacion.
- b) Njoftimet përkatëse në zyrat e taksave në lidhje me operacionin e mësipërm.
- c) Kalimin e punonjësve nga Shoqëria e Përthithur në shoqërinë përthithëse.

Neni 14

DEKLARIMET DHE GARANCITE

Deklarimet dhe Garancite e POSTA SHQIPTARE sh.a:



- POSTA SHQIPTARE sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Projekt-Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.
- POSTA SHQIPTARE sh.a nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirje ose në proces likuidimi.

Deklarimet dhe Garancite e INTERPOST sh.p.k:

- Interpost sh.p.k dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Projekt-Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.
- Interpost sh.p.k nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirje ose në proces likuidimi.

Neni 15

ZGJIDHJA E PROJEKT-MARRËVESHJES

Kjo Projekt-Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë para Datës së Mbylljes me aprovimin me shkrim të të dyja paleve.

Kjo Projekt-Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë me anë të njoftimit me shkrim të pala tjetër, para Datës së Mbylljes, nëse Bashkimi nuk përfundon.

Neni 16

KONFIDENCIALITETI

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfuara si rezultat i nisjes dhe përmbushjes së kësaj Projekt-Marrëveshje, të cilat kanë lidhje me negociatat, për mbushjen dhe mbylljen e kësaj Projekt-Marrëveshje ose të çdo dokumenti që referohet nga kjo Projekt-Marrëveshje. Palët mund t'i japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- a) Kërkohet nga ligji ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
- b) Kërkohet nga ndonjë institucion qeveritar
- c) Me miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

Neni 17

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Projekt-Marrëveshje rregullohet në të gjitha aspektet nga ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



Neni 18 **TË PËRGJITHSHME**

Përfaqësuesit ligjor të shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedure bashkimi me përthithje, do të hartojnë sipas ligjit (nenit 216) një raport të hollësishëm, në të cilin do të shpjegohen marrëveshja e bashkimit dhe bazat ligjore dhe ekonomike për të, vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat mund të jenë hasur. Raporti do të përshkruajë edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.

Kjo projekt Projekt-Marrëveshje bashkimi dhe raporti do të depozitohen sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për marrjen e vendimit të përcaktuar në nenin 218 të ligjit 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, duke publikuar edhe pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundit.

Autorizohet Z. Desar Peçi, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për depozitim të të gjitha akteve për realizimin e kësaj procedure të bashkimit me përthithje.

Neni 19

TË NDRYSHME

- a) Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kërkuara apo dhe të lejuara nga kjo Projekt-Marrëveshje do të dorëzohen dorazi ose me anë të postës në adresën si më poshtë vijon, derisa Palët të njoftojnë njëri-tjetrin për ndryshime të adresave të tyre.

Për Posta Shqiptare sh.a:

Rruga Rreshit Çollaku, nr 4, Tiranë
Në vëmendje të: z. Majlind Lazimi

Për Interpost sh.p.k:

Rruga Rreshit Çollaku, nr 4, Tiranë
Në vëmendje të: z. Kujtim Sejati

- b) Ndryshime

Asnjë ndryshim i kësaj Projekt-Marrëveshje nuk do të jetë i vlefshëm përveçse me shkrim dhe e nënshkruar nga palët.

Kjo Projekt-Marrëveshje u hartua sot më datë _____, në 6 kopje orgjinale dhe u nënshkrua nga:

Shoqëria
POSTA SHQIPTARE SHA
Përfaqësuar nga:


z. Majlind Lazimi
Administrator

Shoqëria
INTERPOST SHPK
Përfaqësuar nga:


z. Kujtim Sejati
Administrator